



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA**  
**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
**OSNOVNI SUD PRIŠTINA - BASIC COURT OF PRISTINA**

---

AD/GJTHPR/10/22

Autoriteti Kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Kryetarja e Gjykatës, Albina Shabani Rama, ka shqyrtuar ankesën e ushtruar nga avokatët SH.S dhe A.P, ndaj gjyqtares E.E, për të vendosur për çështje disiplinore, duke vepruar në mbështetje të nenit 9, paragrafi 6 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 7, paragrafi 1 dhe 3 të Rregullores Nr.05/2019 Për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, me datë 10.03.2022 nxjerr këtë:

**V E N D I M**

Refuzohet si e pabazuar ankesa e ushtruar nga avokatët SH.S dhe A.P, ndaj gjyqtares E.E, për shkak se nuk ka bazë të arsyeshme për inicim të procedurës disiplinore.

**A r s y e t i m**

Avokatët SH.S dhe A.P me datë 16.02.2022 në Gjykatën Themelore në Prishtinë kanë ushtruar ankesë për inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtares E.E. Me datë 18.02.2022 është njoftuar Këshilli Gjyqësor për pranimin e ankesës. Gjithashtu të njëjtën ankesë avokatët SH.S dhe A.P e kanë parashtruar edhe përmes Këshillit Gjyqësor të Kosovës, e cila është pranuar në kompetencë nga Autoriteti i Gjykatës Themelore në Prishtinë me datë 21.02.2022.

Parashtruesit kanë paraqitur ankesë disiplinore ndaj gjyqtares E.E për shkak të pretendimeve se në lëndën CP.nr.643/2020 ku kreditor është S.Z ndërsa debitor është LKIA J.S.C gjykata me datë 27.01.2022 i ka bllokuar llogaritë e debitorit, kurse pagesa ndaj kreditorit është bërë me datë 05.11.2021. Tutje, sipas parashtruesve, gjyqtarja ka rënë ndesh edhe me nenin 5 par.2 pika 2.1 dhe 2.2 të Ligjit Nr.06/L-57 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, për shkak se të paditurën LKIA J.S.C asnjëherë nuk e ka trajtuar të barabartë sepse është Investitor i huaj dhe me këto veprime – sipas tyre – ka rënë ndesh me parimin e pavarësisë dhe paanshmërisë gjyqësore sepse ka paragjykuar në bazë të prejardhjes dhe në këtë mënyrë ka aprovuar çdo kërkesë të palëve paditëse kundër palës se paditur LKIA J.S.C, konkretisht në këto lëndë: C.nr.555/20, C.nr.504/20, C.nr.503/20, C.nr.502/20, C.nr.498/20, C.nr.494/20, C.nr.492/20, C.nr.490/20, C.nr.490/20, C.nr.486/20, C.nr.481/20, C.nr.464/20, C.nr.461/20, C.nr.460/20, dhe C.nr.725/19.

Në lidhje me pretendimet e paraqitësit të ankesës, gjyqtarja e çështjes ka deklaruar se, për lëndën CP.nr.643/2020 ku kreditor është S.Z, dhe debitor është LKIA J.S.C, gjykata i ka bllokuar

Ilogaritë e debitorit me dt. 27.01.2022, pasi që deri me këtë datë gjykata nuk ka pasur asnjë njoftim nga palët në procedurë se të njëjtit kishin arritur marrëveshje jashtëgjyqësore, e që debitori e kishte përmbushur në tërësi detyrimin ndaj kreditorit. Ndërkohë, pas lëshimit të urdhëresës nga kjo gjykate me dt. 27.01.2022 për bllokimin e mjeteve të debitorit të cilat ishin objekt i permbarimit, gjykata është informuar nga palët në procedurë se të njëjtit i kishin përmbushur detyrimet e tyre me dt. 05.11.2021, dhe me të kuptuar këtë fakt, nga gjykata menjëherë janë njoftuar të gjitha Bankat e licencuara nga BQK në Kosovë, që t'ia zhblokoi të gjitha llogaritë e bllokuara të debitorit nga kjo gjykatë, ku edhe janë zhblokuar menjëherë, dhe e paditura nuk ka pësuar asnjë humbje se ka qenë çështje ditësh.

Tutje, gjyqtarja e çështjes ka theksuar se, sa i përket lëndëve civile të fushës nga marrëdhënia e punës, nuk mund t'i komenton vendimet të cilat i ka marrë si gjyqtare individuale, është Gjykata e Apelit të Kosovës e cila i ekzaminon vendimet e gjykatës së shkallës së parë. Për më tepër, gjyqtarja ka theksuar se, të gjitha këto lëndë janë në procedurën e ankimimit në Gjykatën e Apelit të Kosovës.

Autoriteti kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, deklarimit të gjyqtarës dhe pretendimeve të parashtruesve të ankesës, ka vlerësuar se nuk ka dyshim të arsyeshëm për inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtarës E.E.

Autoriteti i kësaj Gjykate bazuar në faktet e çështjes ka gjetur se, nuk ka baza të arsyeshme për inicimin e hetimeve për shkelje disiplinore në veprimet e gjyqtarës E.E, lidhur me aktgjykimet e marra, për të cilat parashtruesit janë ankuar.

Lidhur me pretendimin e palës ankuese se gjyqtarja E.E ka qenë e njëanshme në veprimet e tij gjatë procedurës permbarimore në lëndën CP.nr.643/2020 për faktin se me datë 27.01.2022 përmes aktvendimit CP.nr.643/20 ka bllokuar llogaritë e debitorit, kurse pagesa ndaj kreditorit është bërë me datë 05.11.2021, Autoriteti i kësaj gjykate vë në pah se gjyqtarja nuk ka qenë në dijeni që palët në procedurë kishin arritur marrëveshje jashtëgjyqësore sepse nuk ka pranuar asnjë njoftim nga palët që debitori e kishte përmbushur në tërësi detyrimin ndaj kreditorit dhe posa gjykata ka marrë njoftimin e datës 28.01.2022 nga i autorizuari i kreditorit se detyrimi është përmbushur nga ana e debitorit, gjyqtarja e rastit menjëherë përmes njoftimit zyrtar i ka njoftuar të gjitha Bankat e licencuara nga BQK në Kosovë, që t'ia zhblokoi të gjitha llogaritë e bllokuara të debitorit nga kjo gjykatë, andaj duke pasur parasysh këtë fakt, Autoriteti Kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë vlerëson se nuk është shkelur parimi i trajtimit të barabartë të palëve në procedurë, i përcaktuar me dispozitën e nenit 5, par.2, nën-paragrafi 2.2 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Ndërsa, lidhur me pretendimin e palës ankuese, se gjyqtarja E.E ka qenë e njëanshme në veprimet e tij gjatë procedurës gjyqësore lidhur me rastet, C.nr.555/20, C.nr.504/20, C.nr.503/20, C.nr.502/20, C.nr.498/20, C.nr.494/20, C.nr.492/20, C.nr.490/20, C.nr.490/20, C.nr.486/20, C.nr.481/20, C.nr.464/20, C.nr.461/20, C.nr.460/20, dhe C.nr.725/19, Autoriteti Kompetent i kësaj gjykate nuk ka gjetur bazë të mjaftueshme për t'i vërtetuar pretendimet e ushtruesit të ankesës, dhe për këtë vlerëson se nuk është shkelur parimi i pavarësisë dhe paanësisë të përcaktuar me dispozitën e nenit 5, par.2, nën-paragrafi 2.1 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Për aplikimin e gabuar të së drejtës materiale apo procedurale nga ana e gjyqtarit/ve gjatë punës së tyre, mund të jetë shkak për ushtrimin mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme në gjykatat e instancave më të larta nga pala e pakënaqur, (gjë që parashtruesit i kanë shfrytëzuar) por nuk mund të konsiderohet shkelje disiplinore.

Në lidhje me aktgjykimet e marra, Autoriteti Kompetent i kësaj gjykate vë në pah se nuk ka të drejtën e komentimit apo ndryshimit të vendimeve të marra nga gjykata përkatësisht nga gjyqtarja, sepse për mënyrën e vendosjes së çështjes, gjyqtari vepron konform ligjit, në bazë të bindjes së lirë, pa asnjë presion apo ndikim nga kushdo qoftë, bazuar në provat/shkresat e lëndës, të thënat e palëve në procedurë si dhe legjislacionit në fuqi.

Andaj, Autoriteti Kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë lidhur me ankesën e ushtruar, bazuar në të dhënat e përshkruara më lartë, vlerësoj se nuk ka bazë të arsyeshme të besoj se gjyqtari ka kryer shkelje disiplinore, për t'i parashtruar Këshillit Gjyqësor të Kosovës kërkesë për fillimin e hetimeve disiplinore.

Nga të cekurat më lartë, në bazë të nenit 7, paragrafi 3, të Rregullores Nr.05/2019, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

## GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

AD/GJTHPR/10/22, me datë 10.03.2022

Albina Shabani Rama

---

Kryetare e Gjykatës Themelore në Prishtinë